



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
KRYETARI

Nr. Prot 3732 / 3.

Datë 03 .12.2018

URDHËR

Nr. 3, datë 03 .12.2018

“PËR CAKTIMIN E DATËS SË HEDHJES SË SHORTIT PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË EMËRIMEVE NË DREJTËSI (TË PËRKOHSHËM)”

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 149/d dhe pikës 11 të nenit 179 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe të nenit 284 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”

URDHËROJ:

1. Hedhjen e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (të përkohshëm) në datën **7 Dhjetor 2018 ora 10.00**.
2. Shorti është i hapur dhe zhvillohet në prani të:
 - përfaqësuesve të dërguar nga Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, Prokuroria e Përgjithshme dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë;
 - Avokatit të Popullit;
 - Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”;
 - Përfaqësuesve të grupeve parlamentare;
 - Përfaqësuesve të përfaqësive të huaja diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë dhe të organizatave partnere ndërkombëtare.
 - medias.
3. Ngarkohen shërbimet e Kuvendit për publikimin e datës dhe orës së hedhjes së shortit në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë dhe dërgimin e njoftimeve pranë institucioneve të parashikuara në pikën 2 të këtij urdhri.

KRYETARI



GRAMOZ RUÇI